



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 04 korrik 2019
Nr. ref.: 1386/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI63/18

Parashtrues

Agim Grushti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 7/2018, të 6 shkurtit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Agim Grushti, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati Ali Latifi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Rev. nr. 7/2018] e 6 shkurtit 2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), i cili i është dorëzuar atij më 7 mars 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe, sipas pretendimit, të gjitha nenet tjera deri tek neni 57 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018, dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 26 prill 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 3 maj 2018, Kryetarja caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.

8. Më 11 maj 2018, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që, bazuar në nenin 21 (Përfaqësimi) të Ligjit dhe rregullin 32 (2) (c) të Rregullores së punës, të dorëzojë një autorizim që dëshmon se ai e përfaqëson parashtruesin e kërkesës në procedurat para Gjykatës.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
11. Më 30 gusht 2018, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi një vendim shtesë në Gjykatë, mirëpo nuk dorëzoi autorizimin e kërkuar.
12. Më 14 shkurt 2019, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin nr. KSH. KI63/18, për caktimin e Kolegjit të ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi.
13. Më 16 maj 2019, Gjykata i dërgoi një kërkesë të përsëritur përfaqësuesit të pretenduar të parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë autorizimin në Gjykatë jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga dita e pranimi të shkresës së Gjykatës.
14. Më 17 maj 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi autorizimin e kërkuar në Gjykatë.
15. Më 20 maj 2019, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
16. Më 6 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Për rreth 35 vite, parashtruesi i kërkesës kishte punuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: QKUK) si *“Përgjegjës i trafave dhe përgjegjës për mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e gjeneratorëve”*.
18. Më 1 shtator 2014, QKUK, përmes Vendimit [nr. 3473] e njoftoi parashtruesin e kërkesës se për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare, marrëdhënia e punës do t'i përfundojë më 7 shtator 2014. Kjo e fundit paraqet datën e pensionimit të parashtruesit të kërkesës.

19. Më 2 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë kundër Vendimit të lartcekur në Komisionin e Ankesave të QKUK-së, duke kërkuar që t'i paguhet dy paga mujore dhe dy jubilarë si rezultat i pensionimit të tij.
20. Më 4 shtator 2014, Komisioni i Ankesave i QKUK-së përmes Vendimit [nr. 162/14] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se *“nuk ka bazë ligjore për realizimin e kërkesës”* së parashtruesit të kërkesës.
21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) duke kërkuar që të detyrohet QKUK t'i njoh kompensimin e dy pagave jubilarë, si dhe dy pagave mujore përcjellëse për shkak të pensionimit. Gjithsej, përmes kërkesëpadisë së tij, parashtruesi i kërkesës kërkonte 2,077.92 euro dhe kamatën respektive.
22. Më 28 prill 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 2824/14] e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Si arsye për refuzim të kërkesëpadisë Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi se: (i) Kontrata Kolektive të cilës i referohej parashtruesi i kërkesës kishte qenë në fuqi vetëm për tri vite dhe atë prej 1 janarit 2005 deri më 1 janar 2008 dhe rrjedhimisht, në kohën e pensionimit të parashtruesit të kërkesës nuk ka ekzistuar normativa ligjore për kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse në pension; dhe (ii) në kohën e pensionimit të parashtruesit të kërkesës, e paditura, përkatësisht QKUK, nuk ishte nënshkruese e ndonjë Kontrate Kolektive e cila do ta obligonte që me rastin e pensionimit të punëtorëve të saj t'u paguaj atyre paga për shpërblim jubilar dhe për përcjellje në pension.
23. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
24. Më 23 tetor 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC. nr. 2435/2017] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.
25. Gjykata e Apelit vlerësoi se pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës ishin të pabazuara duke qenë se Kontrata Kolektive të cilës ai i referohej ishte lidhur në mes të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Odës Ekonomike të Kosovës dhe, si rrjedhojë, në mënyrë që ajo Kontratë të ishte e aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës do të duhej që Federata Sindikale e Organeve të Ministrisë së Shëndetësisë të kishte lidhur Kontratë të posaçme me punëdhënësin e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht QKUK-në. Në rastin konkret, sipas Gjykatës së Apelit, QKUK, si punëdhënëse e parashtruesit të kërkesës, *“nuk ka lidhur kurrfarë kontrate kolektive me federatën e punëtorëve të shëndetësisë dhe në këtë kontekst nuk ka kurrfarë obligimi për të zbatuar dispozitën e Kontratës Kolektive”*. Më tutje, Gjykata e Apelit ritheksoi faktin se parashtruesi i kërkesës i është referuar Kontratës së Përgjithshme Kolektive e cila ka qenë në fuqi vetëm deri më 31 dhjetor 2008, ndërkaq që ai ka

arritur moshën e pensionimit në shtator të vitit 2014, kur e njëjta nuk ka qenë më e zbatueshme për punonjësit në Republikën e Kosovës. Sipas Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës po ashtu është pensionuar në periudhën para se të hyjë në fuqi Kontrata e tanishme Kolektive e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2015 dhe si e tillë, nuk mund të aplikohet në mënyrë retroaktive për parashtruesin e kërkesës.

26. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
27. Më 6 shkurt 2018, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 7/2018] hodhi si të palejuar kërkesën e parashtruesit për revizion, sepse vlera e kontestit ishte nën limitin ligjor prej 3,000 euro në bazë të të cilit, sipas paragrafit 2 të nenit 211 (Revizioni) të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), do të lejohej paraqitja e revizionit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke refuzuar revizionin e tij si të palejuar, përmes Aktvendimit të kontestuar, i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shkelja e nenit 3 të Kushtetutës konsiston në atë që jo të gjithë po trajtohen në mënyrë të barabartë meqë, sipas tij, ekzistojnë raste kur *“dy mësues, shokë të klasës - njeri e fiton dhe tjetrit i refuzohet nga e njëjta gjykatë, gjyqtarë, duke e arsyetuar se po veprojmë sipas “vendimeve” që ka marrë Gjykata Supreme?! [...]”*. Shkelja e nenit 3 të Kushtetutës, sipas parashtruesit të kërkesës, bëhet edhe nga vet Gjykata Supreme e cila *“nuk lëshohet në garancionin që jep Kushtetuta ndaj të gjithëve pa dallim”*.
30. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 90 (Marrëveshja Kolektive) të Ligjit 03/L-212 të Punës (në tekstin e mëtejme: Ligji i Punës) dhe paragrafit 4 të nenit 211 të LPK-së.
31. Sa i përket të parës, sipas parashtruesit të kërkesës, punëdhënësi i tij, respektivisht QKUK-ja *“nuk ka zbatuar nenin 90 të Ligjit të Punës dhe Kontratave Kolektive nga viti 2005 deri më 2017, duke shkelë LTHDN të garantuara me Konventë Ndërkombëtare të vitit 1948, Kushtetutën e Kosovës kapitulli I dhe II të dispozitave themelore (faqe 1-5), si dhe Ligjin e Punës, Kontratat Kolektive të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës, Ministria për Punë dhe Çështje Sociale, Oda Ekonomike, Sindikata Qendrore që garantojnë të gjitha shërbime publike dhe private që pas pensionimit për çdo 10 vite të paguhet 1 pagë, dhe 3 paga përcjellëse [...]”*.
32. Sa i përket të dytës, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka zbatuar gabimisht paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së, sepse, në kontekste të punës, i njëjti përjashtohet përmes paragrafit 4 të nenit 211 të LPK-së.

33. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“të zbatohet ligjshmëria dhe kushtetutshmëria, ligji i punës, kontrata kolektive, që qeveritë që po vijnë në pushtet garantojnë dhe nuk i zbatojnë”*.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
35. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

[...]

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Gjykata, më tej, i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 7/2018] e 6 shkurtit 2018 të Gjykatës Supreme pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

38. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

39. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pas përfundimit të marrëdhënies së punës me QKUK-në, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, kishte filluar procedurat fillimisht administrative dhe më pas ato gjyqësore, në lidhje me kompensimin e dy pagave jubilarë dhe dy pagave përcjellëse për në pension. Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kishin refuzuar kërkesën e tij si të pabazuar, kryesisht me arsyetimin se nuk kishte bazë ligjore për përfitimin e një të drejte të tillë dhe se Kontrata Kolektive të cilës parashtruesi i kërkesës i referohet nuk ishte në fuqi në kohën e pensionimit të parashtruesit të kërkesës. Ndërsa, Gjykata Supreme kishte refuzuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës duke u bazuar në nenin 211 të LPK-së, sipas të cilit revizioni nuk është i lejuar për kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk e kalon vlerën në të holla prej 3,000 euro. Këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës e konteston në Gjykatë, duke pretenduar se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
40. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, në substancë, parashtruesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij nuk ka pasur gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe se ai nuk është trajtuar barabartë krahasuar me disa raste të ngjashme, në të cilat, sipas tij, gjykatat ua ka njohur të drejtën e pagave mujore si shpërblim jubilar pas pensionimit. Sipas tij, Gjykata Supreme ka bërë shkelje të ligjit kur ka përjashtuar nga arsyetimi i saj paragrafin 4 të nenit 211 të LPK-së, duke ia refuzuar kërkesën e tij për revizion si të palejuar dhe ka konstatuar gabimisht që Ligji i Punës dhe Kontrata Kolektive nuk janë të zbatueshme në rastin e tij.
41. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve dhe interpretimin e LPK-së, Ligjit të Punës dhe Kontratës Kolektive nga gjykatat e rregullta.
42. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35). E vetmja mënyrë se si këto pretendime do të mund të shqyrtoheshin dhe të pranoheshin si të bazuara është rasti kur një parashtrues arrin

të dëshmojë, me argumente bindëse se, në rastin e tij konkret, ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së.

43. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së: *García Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
44. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë. (Shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
45. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu vëren që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare. (Shih rastin e GJEDNJ: *Shub kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).
46. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës si “*të palejuar*” në aspekt procedural dhe pa shqyrtuar meritat e kërkesës, duke u bazuar në dispozitat e LPK-së e sipas të cilave kërkesa për revizion duhet të shpallet e palejueshme në rastet kur vlera e kontestit është nën 3,000 euro.
47. Më saktësisht, Gjykata Supreme në Aktvendimin e saj kishte theksuar si në vijim:

“Sa i përket revizionit Gjykata Supreme e Kosovës, konkludoi se revizioni është i palejuar, ngase vlera e kontestit në këtë çështje juridike është 2.077,92 euro, e cila nuk i përgjigjet vlerës së kontestit mbi të cilën në kuptim të nenit 211.2 të LPK-së, do të ishte i lejuar paraqitja e revizionit.

Sipas dispozitës të nenit 211.2 LPK revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë detyrimi tjetër, po që se

vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 euro”.

48. Për më tepër, për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme ka refuzuar revizionin në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 211 të LPK-së, Gjykata rikujton se neni i referuar nga parashtruesi i kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me shkronjën (c) të tij dhe aplikohet “*në kontestet nga marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuar kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës*”. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës në rrethanat e rastit konkret, kishte të bëjë me një kontest pasuror-juridik në të cilin kërkesëpadia ndërlidhet me kërkesa në të holla, rast ky që specifikisht bie në fushëveprimin e paragrafit 2 të nenit 211 të LPK-së dhe siç e kishte konfirmuar edhe Gjykata Supreme, për të qenë i lejuar revizioni në këto çështje, duhet që vlera e objektit të kontestit të jetë më e lartë se 3,000 euro.
49. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate tregon se ka pasur edhe raste të tjera kur është kontestuar një Aktvendim i Gjykatës Supreme, sikurse ky i tanishmi, përmes së cilit ishin refuzuar si të palejuara kërkesat për revizion në të cilat vlera e kontestit ishte nën 3,000 euro. Në rastet e tilla Gjykata, sikurse në rastin e tanishëm, ka vlerësuar nëse tërësinë e procedurave parashtruesit përkatës kanë përfituar nga një gjykim i drejtë dhe i paanshëm, duke mos u lëshuar në çështje të ligjshmërisë dhe aspekteve të interpretimit të ligjit procedural dhe material, duke qenë se kompetenca të tilla, siç është cekur më lart, janë nën juridiksionin primar të gjykatave të rregullta. Rastet e tilla, Gjykata i ka shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese ku është kontestuar një vendim i Gjykatës Supreme që kërkesën për revizion e ka refuzuar në baza procedurale si të palejueshëm: KI66/18 parashtrues *Sahit Muçolli*, Aktvendim i 6 dhjetorit 2018; KI110/16 parashtrues *Nebojsa Dokić*, Aktvendim i 24 marsit 2017; KI24/16 parashtrues *Avdi Haziri*, Aktvendim i 4 nëntorit 2016; KI112/14 parashtrues *Srboljub Krstić*, Aktvendim i 19 janarit 2015; KI84/13 parashtrues *Gani, Ahmet dhe Nazmije Sopaj*, Aktvendim i 18 nëntorit 2013).
50. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore e tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44; shih rastet e bashkuara KI150/15, KI161/15, KI162/15, KI14/16, KI19/16, KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
51. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, përkatësisht në Gjykatën Supreme, të Apelit dhe atë Themelore, nuk

mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm apo për barazi para ligjit. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së: *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI56/17, cituar më lart, paragrafi 42).

52. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes Aktvendimit të kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
53. Si përfundim, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 6 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi